<p style="text-align: center;">Neni 9 Detyrimet e personave të grupeve të tjera</p> <p>1. Për të ruajtur shëndetin dhe sigurinë në vendndërtim, personat e vetëpunësuar, furnizuesit, si dhe kontraktorët që personalisht janë të angazhuar në aktivitete pune, apo personat tjerë të angazhuar në bazë të kontratave të posaçme, duhet të respektojnë në veçanti kërkesat vijuese:</p> <p>1.1. kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në punë sipas Ligjit për Siguri dhe shëndet në punë, akteve përkatëse nënligjore, si dhe dispozitave të Shtojcës 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje;</p> <p>1.2. t'i marrin parasysh udhëzimet dhe këshillat nga koordinatori për çështje të sigurisë e shëndetit në vendndërtim.</p>	<p>site is located.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Obligations of persons of other groups</p> <p>1. In order to preserve safety and health on the construction site, self-employed persons, suppliers, and contractors who are personally engaged in work activities, or other persons engaged based on special contracts shall comply in particular with the following:</p> <p>1.1. and health requirements of the Law on Safety and Health at Work and the relevant by-laws, as well as the provision of Annex 3, 4 and 5 of this regulation;</p> <p>1.2. take into account directions and advice from the coordinator for safety and health matters at the construction site.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Obaveze drugih lica</p> <p>1. Za očuvanje bezbednosti i zdravlja na gradilištu, samozaposlena lica, dobavljači kao i ugovarači koji su lično uključeni u aktivnosti rada ili druga lica angažovana shodno posebnim ugovorima, će posebno poštovati sledeće zahteve:</p> <p>1.1. uslove o bezbednosti i zdravlju na radu shodno Zakonu o bezbednosti i zdravlju na radu, odgovarajućih podzakonskih akata, kao i odredbi Priloga 3, 4 i 5 ove uredbe;</p> <p>1.2. uzimanje u obzir uputstava i saveta koordinatora za pitanja bezbednosti i zdravlja na gradilištu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Informimi dhe trajnimi i punëtorëve</p> <p>1. Pa lënë anash nenin 18 dhe 20 të Ligjit nr. 04/L-161, për Siguri dhe shëndet në punë, të punësuarit dhe/ose përfaqësuesit e tyre duhen informuar për të gjitha masat që do të merren në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e tyre, si dhe për rreziqet ndaj të cilave ata mund të ekspozohen në vendndërtim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Information and training of employees</p> <p>1. Without prejudice to the Article 18 and 20 of Law No. 04/L-161, on Safety and Health at Work, employees and/or their representatives shall be informed of all measures to be taken concerning their safety and health, as well as on the risks which they may be exposed to, at the construction</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Informisanje i obučavanje zaposlenih</p> <p>1. Ne izuzimajući član 18. i član 20. Zakona br. 04/L-161 o bezbednosti i zdravlju na radu, zaposleni i/ili njihovi predstavnici moraju biti informisani o svim merama koje se preduzimaju u vezi njihove bezbednosti i zdravlja, kao i o rizicima kojima mogu biti izloženi na gradilištu.</p>

2. Punëdhënësi duhet të sigurojë trajnimin dhe udhëzimet e duhura për siguri dhe shëndet në punë në vendndërtim para fillimit të punës, duke marrë parasysh edhe ndryshimin e vazhdueshëm të gjendjes në vend pune.

3. Informimi adekuat në lidhje me sigurinë dhe shëndetin, si dhe për rreziqet e mundshme në vendndërtim duhet ofruar edhe për personat e vetëpunësuar dhe punëtorët e nën-kontraktorëve të tjerë në fjalë.

Neni 11
Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarëve

1. Punëdhënësi duhet të ndërmarrë masat e duhura për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëtorëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Siguri dhe shëndet në punë, në lidhje me çështjet e mbuluara me këtë rregulloreje.

2. Kjo duhet të bëhet duke marrë në konsideratë kushtet e posaçme dhe veçantinë e vendndërtimeve mobile dhe të përkohshme, duke siguruar kurdo që është e mundshme koordinimin e mirëfilltë ndërmjet punëtorëve dhe/ose përfaqësuesve

site.

2. The employer shall ensure suitable training and instructions on safety and health at work at the construction site before commencing work, taking into account the changing conditions at the worksite

3. The adequate information concerning safety and health, as well as potential risks at the construction site and shall be provided also to self-employed persons and employees of other subcontractors concerned.

Article 11
Consultation and participation of employees

1. The employer shall take appropriate measures for the consultation and participation of employees and/or their representatives in accordance with Article 13 of the Law on Safety and Health at Work, concerning matters covered by this Regulation

2. Taking into consideration of the specific conditions and particularity of the mobile and temporary worksite, ensuring whenever necessary proper coordination between employees and/or employees' representatives, having regard the degree of

2. Poslodavac će obezbediti odgovarajuću obuku i uputstva o bezbednosti i zdravlju na radu na gradilištu pre početka samog rada, uzimajući u obzir stalne promene stanja na radnom mestu.

3. Odgovarajuće informacije o bezbednosti i radu, kao i informacije o mogućim rizicima na gradilištu, će se obezbediti i za samozaposlena lica i zaposlene koji rade za podgovarače.

Član 11
Konsultacija i zastupljenost zaposlenih

1. Poslodavac će preduzeti odgovarajuće mere za konsultaciju i zastupljenost zaposlenih i/ili njihovih predstavnika, u skladu sa članom 13. Zakona o bezbednosti i zdravlju na radu, u vezi pitanja na koje se odnosi ova uredba.

2. To se radi uzimajući u obzir posebne uslove i karakteristiku pokretnih i privremenih gradilišta, obezbeđujući, kad god je to moguće, odgovarajuću koordinaciju sa zaposlenima i/ili njihovim predstavnicima, uključujući i stepen rizika i

të tyre dhetë marrin parasysh edhe shkallën e rrezikut dhe madhësinë e hapësirave të punës.

**Neni 12
Shtojcat**

Shtojcat 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

**Neni 13
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.


Skender Reçica
Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

 /Dhjetor, 2017

risk and the size of the worksite.

**Article 12
Annexes**

The Annex 1, 2, 3, 4 and 5 are an integral part of this regulation.

**Article 13
Entry into force**

This Regulation shall enter into force seven (7) days after the signature of the Minister of Labour and Social Welfare.


Skender Reçica
Minister of Labour and Social Welfare

 /December, 2017

veličinu gradilišta.

**Član 12
Prilozi**

Prilozi 1, 2, 3, 4 i 5 čine sastavni deo ove uredbe.

**Član 13
Stupanje na snagu**

Ova uredba stupa na snagu sedmog (7) dana od potpisivanja iste od strane Ministra rada i socijalne zaštite.


Skender Reçica
Ministar Rada i Socijalne Zaštite

 /Decembar, 2017

Shtojca 1

LISTA E PUNËVE QË BARTIN RREZIQE TË POSAÇME PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN E PUNËTORËVE

1. Puna që vë punëtorët në rrezik të groposjes në thellësi të tokës mbi 5 metra , apo gëlltitjes brenda një moçali.
2. Puna që vë punëtorët në rrezik të rënies nga lartësia, ku ai rrezik rritet nga natyra e punës, proceset që zhvillohen në mjedisin e vendit të punës apo në lartësi më të madhe se 10 metra.
3. Puna që vë punëtorët në rrezik nga substancat kimike, fizike apo biologjike, të cilat bartin rreziqe të posaçme ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, apo që përmbajnë një kriter ligjor për monitorim të shëndetit.
4. Puna me rrezatim jonizues që kërkon përcaktimin e sipërfaqeve të kontrolluara apo të mbikëqyrura.
5. Puna afër linjave energjetike të tensionit të lartë.
6. Puna që i ekspozon punëtorët ndaj rrezikut të mbytjes.
7. Puna në puse, gërmime nëntokësore dhe tunele.
8. Puna që kryhet nga zhytësit me sistem të furnizimit të ajrit.
9. Puna që kryhet nga punëtorët në dhomëza nënujore me atmosferë ajri të komprimuar.
10. Puna që përfshin përdorimin e eksplozivëve.
11. Puna që përfshin montimin apo çmontimin e elementeve të rënda të parafabrikuara.

FORMULAR MOSTËR
Sipas referimit tek neni 4 i kësaj rregulloreje

NJOFTIMI I REGJISTRIMIT TË NDËRTIMIT

Investitori:

Emri i kompanisë:

Adresa:

Nr. i regjistrimit të kompanisë:

Emri i përfaqësuesit ligjor: adresa e emailit:

Të dhënat për vendndërtimin:

Adresa e saktë e vendndërtimit:

Lloji i ndërtimit:.....

.....

Data e planifikuar për fillimin e punës në vendndërtim:

Kohëzgjatja e planifikuar e punës në vendndërtim:

Numri i vlerësuar maksimal i punëtorëve në vendndërtim:

Mbikëqyrësi(t) e projektit-

Emri(at).....

Adresa(t):

Koordinatori(ët) për siguri dhe shëndet në punë për projektin

Emri(at) dhe adresa(t).

.....

Koordinatori(ët) për siguri dhe shëndet në punë për fazën e ekzekutimit të projektit

Emri(at) dhe adresa(t):

.....

Kontraktori:

Emri i kompanisë dhe adresa.....

.....

Nr. I regjistrimit të kompanisë: adresa e emailit:.....

Emri i përfaqësuesit ligjor:

Kontaktet e telefonit dhe emailit:

.....

Numri i planifikuar i kontraktorëve (nën-kontraktorëve)

Numri i planifikuar i personave të vetëpunësuar në vendndërtim:

Detajet e kontraktorëve që janë zgjedhur:

Data:

Emri dhe nënshkrimi i
përfaqësuesve të investitorit, vula

Regjistrimi në Inspektoratin e Punës:

Data:

Shtojca 3

KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURI E SHËNDET PËR VENDE PUNE NË VENDNDËRTIM

Përmendur në nenet 9 dhe 11 të rregullores

Vërejtje paraprake

Detyrimet e vendosura me këtë Shtojcë vlejné kurdo që është e nevojshme sipas trajtave të vendndërtim, aktivitetit të caktuar, rrethanat apo rrezikut.

Për qëllimet e kësaj Shtojce, «dhomat» përfshijnë, mes tjerash, edhe akomodimin nën mbulojë.

1. Stabiliteti dhe qëndrueshmëria fizike

1.1 Hapësirat duhet të kenë strukturën dhe stabilitetin e përshtatshëm për natyrën e përdorimit të tyre.

1.2 Materialet, pajisjet dhe më përgjithësisht, çdo komponent i cili kur lëviz në një drejtim, mund të ndikojë në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, duhen stabilizuar në mënyrë të mirëfilltë dhe të sigurt.

1.3 Qasja në sipërfaqe që përmbajnë materiale me rezistencë të pamjaftueshme nuk është e autorizuar, përveç nëse sigurohen pajisje apo mjete të përshtatshme për të mundësuar kryerjen e sigurtë të punëve.

1.4 Vendet e punës të vendosura në nivele të larta apo të ulëta e të cilat janë të fiksuara apo të lëvizshme duhet të jenë stabile dhe fizikisht të qëndrueshme, duke marrë parasysh:

- numrin e punëtorëve që punojnë në to.
- ngarkesat maksimale që duhet të bartin dhe shpërndarjen e peshës.
- ndikimet e jashtme të cilave mund t'iu nënshtrohen.

1.5 Nëse mbajtja dhe komponentët tjerë të këtyre vendeve të punës nuk janë stabile përbrenda tyre, stabiliteti i tyre duhet siguruar me metoda të përshtatshme dhe të sigurta të fiksimit, për të shmangur lëvizjen në kohë të gabuar apo papritur të të gjithë lokacionit të punës apo pjesëve të tij.

1.6 Stabiliteti dhe qëndrueshmëria fizike duhen kontrolluar në mënyrë të mirëfilltë e sidomos pas ndryshimeve në thellësi apo lartësi të vendit të punës.

2. Rrugët, daljet dhe dyert emergjente

2.1 Rrugët dhe daljet emergjente duhet të mbesin të lira dhe të drejtojnë sa më shpejt që është e mundur drejt një sipërfaqeje të sigurt.

2.2 Në rast të rrezikut, duhet të jetë e mundur që punëtorët të evakohen nga të gjitha vendet e punës sa më shpejt dhe sa më sigurt që është e mundur.

2.3 Numri, shpërndarja dhe dimensionet e rrugëve dhe daljeve emergjente varen nga përdorimi, pajisjet dhe dimensionet e vendndërtimit, si dhe të dhomave dhe numrit maksimal të personave që mund të jenë të pranishëm.

2.4 Rrugët dhe daljet specifike emergjente duhen shenjuar me shenja në pajtim me Rregulloren për Shenjat e Sigurisë dhe Shëndetit.

Shenjat e tilla duhet të jenë mjaftueshëm rezistente ndaj kushteve përreth si dhe të vendosen në pikat e duhura.

2.5 Rrugët dhe daljet emergjente, si dhe rrugët e lëvizjes dhe dyert që i japin qasje atyre, duhet të jenë të lira nga pengesat ashtu që të mund të shfrytëzohen dhe përdoren pa pengesa.

2.6 Rrugët dhe daljet emergjente që kërkojnë ndriçim duhet të pajisjen me ndriçim emergjent me intensitet adekuat në rast se ndriçimi dështon.

2.7 Daljet emergjente duhet të hapën së jashtmi.

2.8 Dyert emergjente nuk duhen kyçur apo mbyllur ashtu që të mos mund të hapen lehtë dhe shpejt nga cilido person që mund të ketë nevojë t'i përdorë ato në një emergjencë.

2.9 Dyert rrëshqitëse apo rrotulluese nuk lejohen nëse mëtohen të përdoren si dalje emergjente.

3. Zbulimi i zjarrit dhe fikja e zjarrit

3.1. Varësisht nga karakteristikat e vendndërtimit, dimensionet dhe destinimi i dhomave, pajisjet në lokacion, karakteristikat fizike dhe kimike të substancave të pranishme dhe numrit maksimal potencial të njerëzve të pranishëm, duhet siguruar një numër adekuat të pajisjeve të mirëfillta zjarrfikëse, si dhe sipas nevojës, detektorë zjarri dhe sisteme alarmimi.

3.2. Këto pajisje zjarrfikëse, detektorë zjarri dhe sisteme alarmi duhen kontrolluar dhe mirëmbajtur rregullisht.

Testimet dhe shpimet e duhura duhen bërë në intervale të rregullta.

3.3. Pajisjet joautomatike zjarrfikëse duhet të jenë lehtësisht të qasshme dhe të thjeshta për përdorim. Pajisja duhet shenjuar me shenja në pajtim me dispozitat e Rregullores për Shenja të Sigurisë dhe Shëndetit.

Shenjat e tilla duhet të jenë mjaftueshëm rezistentë dhe të vendosen në pikat e duhura.

4. Ajrimi

4.1 Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar ajër të mjaftueshëm të pastër, duke pasur parasysh metodat e punës që përdoren dhe kërkesat fizike që i imponohen punëtorëve.

4.2 Nëse përdoret sistemi i ajrimit të sforcuar, ai duhet mirëmbajtur për të qenë funksional dhe nuk mund t'i ekspozojë punëtorët ndaj rrymave që janë të dëmshme për shëndetin.

Çdo ndarje e dhomëzave duhet paraqitur në një sistem kontrolli, kudo që kjo është e domosdoshme për shëndetin e punëtorëve.

4.3 Çdo depozitim apo mbeturina që kanë gjasë të krijojnë rrezik të drejtpërdrejtë ndaj shëndetit të punëtorëve duke ndotur atmosferën duhen hequr pa vonesa.

5. Ekspozimi ndaj rreziqeve të caktuara

5.1 Punëtorët nuk i duhen ekspozuar niveleve të dëmshme të zhurmës apo faktorëve të dëmshëm të jashtëm si gazrat, avujt apo pluhuri.

5.2 Nëse punëtorët duhet të hyjnë në një zonë ku atmosfera ka gjasë të përmbajë substanca toksike apo të dëmshme, të jenë të ndezshme ose të kenë nivel të pamjaftueshëm oksigjeni, atmosfera e mbyllur duhet monitoruar si dhe duhen ndërmarrë hapat e duhur për të parandaluar rreziqet.

5.3 Çdo punëtor që punon në hapësira të mbyllura nuk mundet që në asnjë rrethanë t'i ekspozohet një atmosfere të mbyllur me rrezikshmëri të lartë. Ai punëtor duhet që së paku të vëzhgohet nga jashtë në çdo kohë gjatë kryerjes së punës, si dhe duhen marrë të gjitha masat e nevojshme e të përshtatshme të sigurisë për të siguruar ndihmën efektive dhe të menjëhershme në rast nevojë.

6. Temperatura

6.1 Gjatë orarit të punës, temperatura duhet të jetë e përshtatshme për qeniet njerëzore, duke marrë parasysh metodat e punës që përdoren dhe kërkesat fizike që i bëhen punëtorëve.

6.2 Temperatura në hapësirat e pushimit, dhomat për personelin në ndërrim, hapësirat sanitare, kantinat dhe dhomat e ndihmës së parë duhet të jetë e përshtatshme për qëllimin e caktuar të atyre zonave.

7. Ndriçimi i vendeve të punës, dhomave dhe rrugëve të lëvizjes brenda vendndërtimit

7.1 Vendet e punës, dhomat dhe rrugët e lëvizjes duhet të jenë, sa më shumë që është e mundur, të ndriçuara me dritë natyrore dhe të jenë të pajisura me ndriçim adekuat dhe të mjaftueshëm artificial gjatë natës, si dhe kur drita e natyrshme është joadekuate; kurdo që nevojitet, duhen përdorur edhe burimet e bartshme të ndriçimit që janë të mbrojtur nga goditjet.

Ngjyra e dritës artificiale që përdoret nuk duhet të ndryshojë apo ndikojë në perceptimin e sinjaleve apo shenjave paralajmëruese.

7.2 Instalimet e ndriçimit për dhomat, vendet e punës dhe rrugët e lëvizjes duhen vendosur në atë mënyrë që të mos ketë rrezik të aksidentit për punëtorë si pasojë e llojit të ndriçimit që vendoset.

7.3 Dhomat, vendet e punës dhe rrugët e lëvizjes, në të cilat punëtorët i ekspozohen veçanërisht rreziqeve në rast të ndriçimit artificial, duhen pajisur me ndriçim emergjent të intensitetit adekuat.

8. Dyert dhe portat

8.1 Dyert rrëshqitëse duhen pajisur me mjete sigurie për të penguar daljen nga shinat apo rrëzimin e tyre.

8.2 Dyert dhe portat që hapen së larti duhen pajisur me mekanizëm për të siguruar që të mos binë prapa.

8.3 Dyert dhe portat përgjatë rrugëve të evakuimit duhen shenjuar në mënyrën e duhur.

8.4 Në afërsi të portave që kanë për qëllim kryesisht trafikun e automjeteve, duhet të ketë dyert për lëvizje këmbësore, përveç nëse është e sigurt për këmbësorët të kalohet; dyert e tilla duhen shenjuar qartë dhe të mbahen të papenguara në çdo kohë.

8.5 Dyert dhe portat mekanike duhen operuar pa ndonjë rrezikshmëri aksidenti për punëtorët. Ato duhen pajisur me pajisje ndalimi emergjente të cilat janë lehtësisht të identifikueshme e të qasshme si dhe nëse nuk hapen automatikisht në rast të ndërprerjes së energjisë duhet të bëhet e mundur hapja e tyre në mënyrë manuale.

8.6 Pozita, numri, dimensionet e dyerve dhe portave, si dhe materialet e përdorura në ndërtimin e tyre përcaktohen sipas natyrës dhe shfrytëzimit të dhomave apo hapësirave të tilla.

8.7 Dyert transparente duhen shenjuar siç duhet në nivel të dukshëm.

8.8 Dyert dhe portat rrotulluese dhe lëkundëse duhet të jenë transparente dhe të kenë panele të tejdukshme.

8.9 Nëse sipërfaqet transparente apo të tejdukshme në dyer e porta nuk përbëhen nga materiale të sigurta, si dhe nëse ka rrezik që punëtorët të mund të lëndohen nëse dera apo porta copëtohet, sipërfaqet e tilla duhet të jenë të mbrojtura ndaj thyerjes.

9. Dritaret dhe dritaret e kulmit

9.1 Duhet të jetë e mundur që punëtorët në mënyrë të sigurt të hapin, mbyllin, rregullojnë apo fiksojnë dritaret, dritaret e kulmitsi dhe ventilatorët. Kur hapen, ato nuk mund të jenë të pozicionuara ashtu që të përbëjnë rrezik për punëtorët.

9.2 Dritaret dhe dritaret e kulmit duhen projektuar në përputhje me pajisjet apo ndryshe të pajisen me mjete që i mundësojnë të pastrohen pa ndonjë rrezikshmëri për punëtorët që kryejnë atë punë apo për personat tjerë të pranishëm.

9.3. Dritaret, atriomet dhe paravanet me xham duhet të mundësojnë shmangien e efektit të ndriçimit të tepërt, duke pasur parasysh natyrën e punës dhe destinimin e asaj hapësire.

10. Dyshemetë, muret, kulmet dhe plafonët e dhomave

10.1 Dyshemetë e vendeve të punës nuk mund të kenë gunga, vrima apo pjerrina të rrezikshme dhe duhet të jenë të fiksuara, stabile dhe të parrëshqitshme.

10.2 Sipërfaqet e dyshemeve, mureve dhe plafonëve në dhoma duhet të jenë të tilla që të pastrohen e të rregullohen deri në një standard të përshtatshëm të higjienës.

10.3 Murët transparente apo të tejdukshme, e në veçanti ndarjet me xham, në dhoma apo në afërsi të vendeve të punës dhe rrugëve të lëvizjes duhet të jenë të shënjuara qartë dhe të jenë me materiale sigurie, apo të mbuloen nga ato vende apo rrugë lëvizjeje për të mos lejuar që punëtorët të vihen në kontakt me muret apo të lëndohen nëse ato ndarje copëtohen.

10.4 Sipërfaqja e dyshemesë në vend të punës duhet të jetë e tillë që t'i mundësojë punëtorëve liri të mjaftueshme të lëvizjes për të kryer punën e tyre, duke marrë parasysh edhe pajisjet apo aparatet e nevojshme që janë të pranishme.

10.5. Dimensionet e hapësirës dhe vëllimi ajror në hapësira duhet të jenë të mjaftueshme për t'i mundësuar punëtorëve të kryejnë punën e tyre pa rrezik për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e tyre.

11. Rrugët e lëvizjes – sipërfaqet e rrezikshme

11.1. Rrugët e lëvizjes, duke përfshirë shkallët, shkallaret e fiksuar, platformat dhe rampat e ngarkimitduhen kalkuluar, vendosur, shtruar e rregulluar ashtu që të ofrojnë qasje të lehtë, të sigurt dhe të përshtatshme, në mënyrë që të mos rrezikojnë punëtorët e angazhuar në afërsi të këtyre rrugëve të lëvizjes.

11.2. Rrugët që përdoren për lëvizje të këmbësorëve dhe/ose produkteve ndërtimore dhe mallrave tjera, duke përfshirë ato që përdoren për ngarkim dhe shkarkim, duhen dimensionuar në përputhje me numrin e shfrytëzuesve të mundshëm dhe llojin e veprimtarisë që kryhet.

Nëse përdoren mjete transporti në këto rrugë të lëvizjes, duhet të sigurohet hapësirë e mjaftueshme e lirë apo pajisjet adekuate të mbrojtjes për shfrytëzuesit tjerë të vendndërtimit.

Rrugët duhet të jenë të shënjuara qartë, të kontrollohetn dhe mirëmbahen rregullisht.

11.3. Duhet siguruar hapësirë e mjaftueshme ndërmjet rrugëve të lëvizjes së automjeteve dhe dyerve, portave, kalimeve këmbësore, korridoreve dhe kafazit të shkallëve.

11.4. Nëse vendndërtimi ka hapësira me qasje të kufizuar, këto duhen pajisur me pajisje që pengojnë punëtorët e paautorizuar nga hyrja.

Duhen ndërmarrë masa të përshtatshme për të mbrojtur punëtorët që janë të autorizuar të hyjnë në hapësirat e rrezikshme.

Hapësirat e rrezikshme duhen shënjuar qartë me shenja, në pajtim me Rregulloren për Shenja të Sigurisë e Shëndetit.

12. Platforma dhe rampat e ngarkimit

12.1. Platforma dhe rampat e ngarkimit duhet të jenë të përshtatshme për dimensionet e ngarkesave që duhen transportuar.

12.2. Platforma e ngarkimit duhet të kenë së paku një pikë të daljes.

12.3. Rampat e ngarkimit duhet të kenë siguri të mjaftueshme që të mos lejojnë punëtorët të binë nga to.

13. Ndihma e parë

13.1 Punëdhënësi duhet të sigurojë dhënien e ndihmës së parë, si dhe që stafi i trajnuar për ta ofruar atë ndihmë të mund të thirret në çdo moment.

Duhen ndërmarrë masa për të siguruar që punëtorët që janë përfshirë në një aksident apo papritmas janë sëmurë të mund të tërhiqen për trajtim mjekësor.

13.2 Një apo më shumë dhoma të ndihmës së parë duhen siguruar kur shkalla e punimeve apo lloji i veprimtarisë që kryhet kërkojnë të tilla.

13.3 Dhomat e ndihmës së parë duhen pajisur me instalimet dhe pajisjet themelore të ndihmës së parë, si dhe të jenë lehtësisht të qasshme për barelat. Ato duhen shënjuar qartë.

13.4 Përveç kësaj, pajisjet e ndihmës së parë duhet të jenë në dispozicion në të gjitha vendet ku kërkohen nga kushtet e punës.

Këto pajisje duhen shënjuar qartë dhe të jenë lehtësisht të qasshme.

Adresa dhe numri i telefonit për shërbimet urgjente lokale duhet të jenë të vendosura aty ku mund të shihen qartë.

14. Pajisjet sanitare

14.1. Dhomat e zhveshjes (zhveshtoret) dhe dollapët

14.1.1 Të punësuarve duhet siguruar zhveshtore të përshtatshme, nëse ata duhet të veshin uniforma të posaçme të punës, si dhe nëse për arsyet e shëndetit apo moralenuk mund të ndërrohen në ndonjë hapësirë tjetër.

Dhomat e zhveshjes (zhveshtoret) duhet të jenë lehtësisht të qasshme, të kenë kapacitet të mjaftueshëm si dhe të kenë ulëse.

14.1.2 Dhomat e zhveshjes (zhveshtoret) duhet të kenë madhësi të mjaftueshme dhe të kenë mundësi për secilin punëtor, aty ku nevojitet, që të thajë veshmbathjen e punës, veshmbathjen personale, gjërat tjera personale, si dhe për t'i mbyllur ato.

Nëse kërkohet nga rrethanat (p.sh. substancat e rrezikshme, lagështia, papastërtitë), duhen siguruar mundësi për ruajtjen e veshmbathjes së punës në vend të ndarë nga veshmbathjet dhe gjërat personale të punëtorëve.

14.1.3 Duhet të organizohen dhoma të ndara të zhveshjes apo hapësira të ndara për veshje të burrave dhe grave.

14.1.4 Nëse zhveshtoret nuk janë të nevojshme siç kërkohet me pikën 14.1.1 të kësaj Rregulloreje, secili punëtor duhet të ketë një vend në të cilin ai mund të mbyllë veshmbathjet dhe gjërat e tij personale.

14.2. Dushet dhe lavamanet

14.2.1. Nëse kërkohet për shkak të natyrës së punës apo për arsye shëndetësore, punëtorëve duhen siguruar dushe të përshtatshme dhe në numër të mjaftueshëm.

Duhet siguruar mundësi për kabina të ndara dushi apo përdorim të ndarë për burra dhe gra.

14.2.2. Kabinat e dushit duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha për t'i mundësuar secilit punëtor që të pastrohet pa pengesa në kushtet e një standardi të përshtatshëm të higjienës.

Dushet duhet të kenë ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë.

14.2.3. Në rastet kur dushet nuk janë të domosdoshme, në pajtim me fjalinë e parë të pikës

14.2.4. të kësaj Rregulloreje, duhen siguruar një numër i mjaftueshëm i lavamanëve të përshtatshëm me ujë të rrjedhshëm (edhe të nxehtë sipas nevojës) në afërsi të vendeve të punës dhe zhveshtoreve.

Duhet siguruar edhe lavamanë të posaçëm, apo përdorim të ndarë për burra e për gra, kur kjo kërkohet për arsye morale.

14.2.5. Kur ndarjet hapësinore të sallave, dushet dhe lavamanët janë të ndarë nga zhveshtoret duhet të ketë qasje të lehtë ndërmjet këtyre të dyjave.

14.3. Tualetet dhe lavamanët

Duhet siguruar hapësira të posaçme me numër adekuat të tualeteve dhe lavamanëve për punëtorë në afërsi të vendeve të punës, dhomave të pushimit, zhveshtoreve si dhe kabinat që kanë dushe apo lavamanë.

Duhet siguruar lavamanë të posaçëm për përdorim të ndarë për burra e gra.

15. Dhomat e pushimit dhe hapësirat e akomodimit

15.1 Kur siguria apo shëndeti i punëtorëve, e posaçërisht kur kërkohet për shkak të llojit të veprimtarisë që kryhet apo pranisë së një numri të caktuar të punëtorëve, si dhe natyrës së

largët të lokacionit, punëtorëve duhet t'ju sigurohen dhoma pushimi lehtësisht të qasshme dhe hapësira akomodimi.

15.2 Dhomat e pushimit dhe hapësirat e akomodimit duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha dhe të pajisen me numër adekuat të tavolinave e ulëseve me mbështetëse për numrin e punëtorëve në fjalë.

15.3 Nëse mundësitë e këtij lloji nuk ekzistojnë, duhen siguruar hapësira tjera në të cilat punëtorët mund të qëndrojnë gjatë pushimit në punë.

15.4 Hapësirat e fiksuara të akomodimit, përveç nëse përdoren vetëm në raste të jashtëzakonshme, duhet të kenë pajisje të mjaftueshme sanitare, dhomë pushimi dhe dhomë për kohë të lirë.

Ato duhet të pajisen me shtretër, dollapë, tavolina e ulëse me mbështetëse, duke marrë parasysh numrin e punëtorëve, si dhe të ndahen për punëtorët e të dy gjinive, kurdo që është e mundur.

15.5 Duhet marrë masa të përshtatshme për mbrojtjen e atyre që nuk pinë duhan ndaj parahatisë që shkaktohet nga tymi i duhanit në dhoma pushimi dhe hapësira të akomodimit.

16. Gratë shtatzëna dhe nënat gjidhënëse

Punëtorët shtatzëna dhe nënat gjidhënëse duhet të kenë mundësi të shtrihen për pushim në kushte të përshtatshme, sipas nevojës.

17. Punëtorët e me nevoja të veçanta

Vendet e punës duhen organizuar për të marrë parasysh punëtorët me nevoja të veçanta, sipas nevojës.

Kjo dispozitë vlen sidomos për dyert, rrugët e kalimit, shkallët, dushet, lavamanët, tualetet dhe vendet e punës që përdoren apo shfrytëzohen drejtpërdrejt nga ata.

18. Dispozita të ndryshme

18.1. Rrethina dhe perimetri i zonës duhet të jenë të shënuara dhe të vendosura ashtu që të jenë qartë të dukshme dhe të identifikueshme.

18.2. Punëtorët duhet të kenë sasi të mjaftueshme, të ujit të pijes në vendndërtim dhe mundësisht një pije tjetër të përshtatshme joalkoolike.

18.3. Punëtorët duhet që:

- të kenë të siguruar mundësitë për të marrë racionet e tyre ushqimore në kushte të kënaqshme,

- kudo që është e mundur, të kenë të siguruar mundësitë për të përgatitur ushqimet e tyre në kushte të kënaqshme.

18.4. Punëtorët duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike që mund të ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e tyre.

18.5. Kërkesat tjera të Rregullores për Kërkesat minimale të vendit të punës zbatohen në vendndërtim nëse është e nevojshme.

KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR VEPRIMTARINË E PUNËS NË VENDNDËRTIM

Përmendur në nenin 9 dhe nenin 11 të Rregullores

Vërejtjet paraprake

Detyrimet e përcaktuara me këtë Shtojcë zbatohen kurdo që kërkohet sipas veçorive të vendndërtimit, veprimtarisë, rrethanave apo rrezikshmërisë.

1. Puna në lartësi

1.1 Rënia nga lartësia duhet të parandalohet fizikisht, posaçërisht me anë të kornizave të forta, të cilat janë mjaftueshëm të larta dhe kanë së paku një mbrojtëse fundore, një mbajtëse anësore kryesore dhe një të ndërmjetme ose alternativë ekuivalente.

1.2 Në parim, puna në lartësi duhet të kryhet vetëm me pajisjet e duhura apo me anë të pajisjeve të mbrojtjes kolektive, si kornizat metalike, platformat apo rrjetet e sigurisë.

Nëse përdorimi i pajisjeve të tilla nuk është i mundur për shkak të natyrës së punës, duhen siguruar mjete të përshtatshme të qasjes, si dhe rripa sigurie e metoda të tjera të ancorimit për mbrojtje.

2. Sigurimi i vendit të punës në lartësi dhe hapësirave përreth

2.1. Për të shmangur rreziqet ndaj punëtorëve dhe personave të tjerë, hapësirat mbi të cilat kryhet puna në lartësi duhen siguruar mirë.

2.2. Sigurimi i mirë i hapësirave të rrezikuara duhet trajtuar përmes mënyrave të mëposhtme:

2.2.1. Ndalimit të operimit,

2.2.2. Përdorimit të strukturave mbrojtëse në nivel të punës në lartësi apo përdorimi i konstruksioneve rrethuese,

2.2.3. Vendosjes së parmakëve me shufra të dyfishta në lartësi së paku 0,9 m, ku shufrat fiksohen në shtylla bartëse me kapacitet të mjaftueshëm të mbajtes së asaj peshe për punë afatshkurtëra nëse vëllimi i punës nuk tejkalon një ndërrim pune, mund të përdoren mjete e materiale të thjeshta, dhe është e mjaftueshme të kufizohet hapësira e rrezikuar me shufratë njëfishta, eventualisht edhe me litar të tendosur në lartësi prej 0,9 m.

2.2.4. Përmes caktimit të një punëtori kujdestar të emëruar për kohën e rrezikut.

2.3 Zona e mbrojtur që shënon hapësirën e rrezikuar me anë të rrethojës duhet të ketë gjerësi që nga skaji i hapësirës së punës apo dyshemesë së saj prej së paku:

2.3.1. 1.5 m për punë në lartësi prej 3 deri në 10 m;

2.3.2. 2 m për punë në lartësi prej 10 deri në 20 m;

2.3.3. 2.5 m për punë në lartësi prej 20 deri në 30 m;

2.3.4. 1/10-ën e lartësisë së objektit kur puna kryhet në lartësi prej më shumë se 30 m.

2.4. Në vendet e transportimit të materialeve në lartësi të mëdha me ndihmën e pajisjeve bartëse (manuale apo makinerike), zona e mbrojtur duhet zgjeruar për 1 m në secilën anë që nga profili i dyshemesë bartëse të ngarkesës së transportuar, si dhe duhet shënjuar.

3. Punimet në kulme

3.1. Punimet që duhen kryer në sipërfaqe të pjerrëta bëhen nga punëtori kompetent, si dhe duhen marrë masat e duhura të sigurisë.

3.2. Për punimet që kryhen në një pjesë të kulmit, duhen vendosur një numër i mjaftueshëm i shkallëve dhe dërrasave të qëndrueshme të krijuara nga materiale të përshtatshme në kulm.

3.3. Duhet siguruar edhe mbrojtëse apo platforma të përshtatshme në skajin e kulmit të objekteve si silosi etj., kulmi i të cilëve përbëhet nga materiale metalike, për të penguar rënien e punëtorëve.

3.4. Duhet marrë edhe masa për të parandaluar rënien e materialeve, veglave apo edhe objekteve tjera nga kulmi.

3.5. Kur punëtorët duhet të punojnë mbi apo afër kulmit apo në ndonjë sipërfaqeje tjetër që përbëhet nga materiale të thyeshme përmes të cilave është e mundshme rënia, duhen marrë masa parandaluese për të siguruar që ata të mos ecin p në sipërfaqen me materiale të thyeshme apo që të binë në tokë padashje.

Në rast se nuk është e mundur të përdoren masa parandaluese kolektive, si për shembull shtrirja e një rrjeti, punëtorët duhet të lidhen mirë me rripa apo litarë të përshtatshëm sigurie.

4. Hedhja e materialit dhe copëzave

4.1. Hedhja e materialeve dhe copëzave, mbetjeve të substancave ndërtimore, si dhe materialeve në vende pune më të ulëta, rrugë apo sipërfaqe të ngjashme lejohet vetëm në rrethanat që:

4.1.1. vendi i hedhjes duhet të sigurohet (me izolim, ndërprerje të operimit, ruajtje), që të mos lejohet hyrja e personave dhe rrethina e tij të mbrohet nga rënia e materialit apo copëzave të elementit të cilat shpërndahen apo kërcejnë aksidentalisht;

4.1.2. materiali duhet të hidhet në njësi të mbyllura deri tek vendi i deponimit.

4.2. Ndalohet hedhja e materialeve dhe copëzave në rastet kur nuk është e mundur të parashihet me siguri vendi i goditjes, sidomos për fletëzat e çelikut, pllakat apo elementet për mbulimin e kulmit, që mund të tërheqin punëtorët poshtë.

4.3. Duhet ndërmarrë masa mbrojtëse, nëse vërehet pluhuri ose ndonjë efekt tjetër i padëshirueshëm nga hedhja e materialeve.

5. Objektet në rënie

5.1 Kurdo që teknikisht është e mundur, punëtorët duhen mbrojtur nga objektet në rënie me metoda të mbrojtjes kolektive,

5.2 Materialet dhe pajisjet duhen shtruar apo paluar në atë mënyrë që të pengohet rënia apo rrëshqitja e tyre.

5.3 Rrugët e kalimit në vendndërtim duhen mbuluar kurdoherë që nevojitet, apo të ndalohej edhe qasja në zona të rrezikuara.

5.4 Nëse rruga për këmbësorë, për shkak të arsyeve të punës në lartësi, ngushtohet apo është zhvendosur apo është bërë pjesë e rrugës, shiriti i këmbësorëve duhet të ndahet nga profili gjatësor i rrugës me rrethojë mbrojtëse me mbrojtëse të dyfishta me lartësi së paku 1.1 m, të mbulohet me rrjet apo pëlhurë kundër ujit apo baltës që hidhen nga mjetet transportuese dhe të bëhet nivelizimi i lartësive për t'ju shmangur parregullsitë eventuale të lartësive ndërmjet rrugës dhe shiritit për këmbësorë.

6. Punimet e dheut, gërmimet, pusët, punimet nëntokësore dhe tunelet

6.1 Duhet ndërmarrë masa të përshtatshme mbrojtëse gjatë gërmimeve, shpimit të puseve, punimeve nëntokësore apo tuneleve ashtu që të:

6.1.1. Përdoret penda mbrojtëse apo edhe pjerrinat;

6.1.2. Parandalohen rreziqet e rënies së punëtorëve, materialeve, objekteve apo vërshimeve;

6.1.3. Sigurohet qarkullim i mjaftueshëm i ajrit për frymëmarrje të rregullt nëpërmes ventilimit në vendet e punës në mënyrë që ato të mos jenë të rrezikshme apo të dëmshme për shëndetin e punëtorit;

6.1.4. Mundësohet arritja e punëtorëve në vendet e sigurta në rast rreziku nga zjarri, rrjedhe uji apo shembje materiale.

6.2 Para se të fillojë gërmimi, duhet marrë masa për të identifikuar dhe zvogëluar deri në minimum ndonjë rrezik për shkak të kabllave nëntokësore dhe instalimeve tjera të shpërndarjes.

6.3 Duhet siguruar edhe rrugë të sigurta të hyrjes dhe daljes deri tek gërmimi.

6.4 Pirgjet e dheut (dheu i grumbulluar), materialet dhe automjetet lëvizëse duhen mbajtur larg gërmimeve; duhen vendosur mbrojtëset e përshtatshme sipas nevojës.

6.5 Në rastet të gërmimit dhe punëve të dheut, për të shmangur rrezikimin e personave që punojnë aty apo që janë në afërsi, pjesa anësore e gërmimeve duhet të sigurohet me materiale të përshtatshme, në sasi dhe cilësi të mjaftueshme; nëse është e nevojshme duhet të mirren edhe masa tjera mbrojtëse të përshtatshme.

6.6 Sigurimi i cilësdo pjesë të gërmimeve, pusit, punimeve të dheut apo tuneleve me dërrasa të përshtatshme apo mënyra të tjera duhet të bëhet nga punëtorë me përvojë, nën mbikëqyrjen e menaxherit të vendndërtimit apo personit të caktuar nga ai.

6.7 Shtyllat dhe dërrasat mbështetëse që përdoren duhet të jenë të prodhuara nga materiale të forta, të mos kenë defekte të dukshme, të jenë mjaft të qëndrueshme, si dhe të mirëmbahen në mënyrë të rregullt.

6.8 Në gërmime më të thella sesa 120 cm, muret anësore duhen fortifikuar me mbështetje të përshtatshme apo ankorim, ndërsa skajet e dërrasave që përdoren për mbështetje do të jenë 20 cm më të larta sesa skaji i sipërm i gërmimit.

6.9 Çdo pjesë e punimeve të gërmimit, pusit, dheut apo tuneleve ku personat punojnë duhet të kontrollohet nga menaxheri i vendndërtimit apo personi që caktohet nga ai së

paku një herë në ditë gjatë periudhës së punës së atyre personave. Në rastet kur punimet bëhen 2 m nën nivelin e sipërfaqes së tokës, dyshemeja dhe skaji më i lartë i pusit duhet kontrolluar para fillimit të secilit ndërrim punëtorësh.

6.10 Dosja që përgatitet nga personi që kryen kontrollin, siç përcaktohet me pikën 6.9 të kësaj Shtojce, do t'i bashkëngjitet dosjes së punimeve të ndërtimit, duke përfshirë datën e kontrollit, rezultatet, si dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e përgadit atë.

6.11 Në rast se ka mundësi që gërmimet apo punimet e dheut të dobësojnë sigurinë e cilësdo strukturë, duhen ndërmarrë masat e sigurisë që kërkohen para fillimit të atyre punimeve gërmuese.

6.12 Operatorët dhe vozitësit e automjeteve, makinerisë gërmuese dhe manipulimit të materialeve duhet të kenë trajnim të posaçëm.

6.13 Duhet marrë masa parandaluese për të siguruar që automjetet, makineria gërmuese dhe manipuluese e materialeve të mos binë brenda gërmimit apo në ujë.

6.14 Kudo që është e mundur, makineria gërmuese dhe ajo për trajtimin e materialeve duhet të jetë e pajisur për të mbrojtur vozitësin apo operatorin nga ndrydhja në rast përmbysjeje të makinësi dhe nga objektet në rënie.

7. Rrethina e gërmimeve

7.1. Është e ndaluar vendosja e materialeve në tokë afër gërmimeve, pusit apo kanaleve në atë mënyrë që rrezikon personat që punojnë në pjesën e poshtme të gërmimeve.

7.2. Kur punimet e gërmimit, puseve apo kanaleve bëhen në ndonjë fushë, ato duhen rrethuar me parmakë (rrethojë) mbrojtës me lartësi prej së paku 90 cm si dhe merren masa tjera të përshtatshme të sigurisë për të mbrojtur punëtorët dhe kalimtarët nga rënia në gropë.

7.3 Para fillimit të punimeve gërmuese në zona të banuara, sipërfaqja e gërmimit duhet rrethuar me rrethojë me strukturë fizikisht të qëndrueshme me lartësi mesatare prej 2 metrash, ndërsa kjo rrethojë duhet mbajtur deri në fund të ndërtimit.

7.4 Shenja paralajmëruese duhet vendosur tek gërmimet në afërsi me rrugët publike apo ato që ndikojnë tek to. Gjatë natës dhe në kohë të dukshmërisë së ulët, këto duhen pajisur me ndriçim të kuq paralajmërues në fillimin dhe fundin e gërmimeve, eventualisht edhe në vende të tjera të rrezikuara në kushtet aktuale. Dritat paralajmëruese përgjatë rrugëve mund të jenë në distancë maksimale prej 50 m nga njëra tjetra.

7.5 Në punime gërmimi më të thellë sesa 0,5 m, duhen krijuar vendkalime të sigurta me gjerësi së paku prej 0,75 m përtej tyre. Në vende publike, pa marrë parasysh thellësinë e gërmimit, duhen instaluar vendkalime me gjerësi së paku 1,5 m. Vendkalimet mbi gërmimet në thellësi prej deri në 1,5 m duhen pajisur me parmakë me një shufër të vetme në dy anë, me lartësi 0.9 m dhe në vende publike me parvaz (prag i ngritur) mbrojtës në pjesën e poshtme në të dyja anët. Vendkalimet mbi gërmime në thellësi mbi 1,5 m duhen pajisur me parmakë (rrethojë) me shufra të dyfishta me parvaz mbrojtës dyshemeje, në të dyja anët.

8. Punimet e rrënit

8.1 Në rastet kur rrënimi i një objekti apo konstruksioni mund të paraqesë rrezik, duhen marrë masa, metoda dhe procedura përkatëse të mbrojtjes;

8.2 Punimet e rrënimt duhen planifikuar dhe ndërmarrë vetëm nën mbikëqyrjen e një personi kompetent.

8.3 Para fillimit të punimeve të rrënimt dhe gjatë kryerjes së këtyre punimeve, të gjitha masat duhen ndërmarrë për të parandaluar ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve për shkak të zjarrit, eksplozimit që mund të ndodh për shkak të rrjedhës, mbledhjes së gazit, avullit apo vërshimeve.

8.4 Është e ndaluar të mbingarkohet një pjesë e konstruksionit apo strukturës me materiale të panevojshme në atë mënyrë që të ekspozojnë punëtorët ndaj rrezikut.

8.5 Punimet vijuese duhen kryer vetëm nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të menaxherit të vendndërtimit apo personit të caktuar nga ai që është kompetent për punë të tilla të caktuara, dhe me masat e nevojshme për të kryer punët pa rrezik për punëtorët:

8.5.1. Rrënimi i një objekti, strukture tjetër apo konstruksioni nëntokësor, plotësisht apo pjesërisht, që bart rrezikun e kolapsit në veçanti;

8.5.2. Prerja e ndonjë pjese mbështetëse që përbëhet nga betoni apo metali, e cila përbën pjesë të objektit, konstruksionit nëntokësor apo ndonjë konstruksioni tjetër që është duke u rrënuar, apo ndonjë strukture metalike;

8.5.3. Në rast se ndonjë pjesë e kornizës së konstruksionit që tërësisht apo pjesërisht mbështetet tek një objekt apo konstruksion nëntokësor ndahet nga objekti apo konstruksioni nëntokësor.

8.6 Para fillimit të punimeve në rrënim dhe gjatë kryerjes së atyre punimeve, duhen ndërmarrë masa adekuate mbrojtëse për të mbrojtur punëtorët nga rreziqet që rezultojnë nga brishtësia apo jostabiliteti i përkohshëm i një strukture. Masat mbrojtëse duhen marrë me pjesë mbështetëse mjaftueshëm të forta për të parandaluar rënien e ndonjë pjese të konstruksionit, si dhe për të parandaluar personat që t'i ekspozohen rrezikut.

8.7 Para fillimit të ndonjë punimi në rrënim si dhe gjatë kryerjes së punimeve të tilla, duhen marrë masa sigurie duke krijuar rrethojë në afërsi të objektit për të mbrojtur kalimtarët.

Në zona të pabanuara, nuk është e nevojshme vendosja e rrethojave nëse sigurohen parrmakë të përshtatshëm apo shirita paralajmërues me lartësi së paku prej 0,9 m lartësi në distancë prej së paku 8 metrash, si dhe në rast se objekti është më i lartë se 8 metra, atëherë aq larg sa lartësia e objektit, për të penguar njerëzit nga afrimi tek vendndërtimi e rrënimt.

8.8 Hyrja e personave të paautorizuar në vendndërtim ku kryhen punë rrënimi është e ndaluar; kjo duhet të jetë e shënuar me tabelë të dukshme.

KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PAJISJET E PUNËS NË VENDNDËRTIM

Përmendur në nenin 9 dhe nenin 11 të Rregullores

Vërejtje paraprake

Detyrimet e përcaktuara me këtë Shtojcë vlejné kurdo që është e nevojshme për shkak të veçorive të vendndërtimeve, veprimtarisë, rrethanave apo rrezikut të caktuar.

Kjo shtojcë plotëson dispozitat e përgjithshme në lidhje me shfrytëzimin e skeleve, pajisjeve bartëse dhe ngritëse, instalimet, makineritë dhe pajisjet tjera të përmendura me Rregulloren (MPMS) 05/2014 për Kërkesat Minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës.

1. Skelet

1.1 Të gjitha llojet e skeleve duhet të jenë të projektuara, ndërtuara e të mirëmbajtura në mënyrë të mirëfilltë, për të siguruar që ato të mos lëvizin apo rrëzohen aksidentalisht.

1.2 Asnjë lloj sistemi skelesh nuk mund të montohet, ndryshohet apo çmontohet pa mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të menaxherit të vendndërtimit apo personit të caktuar nga ai. Personat që janë udhëheqës në këtë drejtim duhet të jenë kompetentë dhe me përvojën e duhur. Çdo herë para përdorimit, materialet që përdoren për skele duhen kontrolluar nga menaxheri i vendndërtimit apo personi i caktuar nga ai.

